



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06-29632/26
Klinë, datë: 10.09/26

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i tetë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e.

Fshatrave, Zllakuqan, Berkovë, Dranashiq, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Rdulloc, Stupë, Rudic, Videjë, Krushev e Madhe, Krushev e Vogel, Budisalc të komunës së Klinës, me, datë 03.09.2026, ora 17:00, SHFMU “Nënë Tereza” Budisalc.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 07/09/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve. Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i Draft-Buxhetit i vitev 2027-2029 i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft-buxheti edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuar.

Takimi ka nisur në ora 17:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor te drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar te ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 13 persona, prej të cilëve, 13 burra, 0 grua

Shtojca 8 – Fotografi nga dëgjim i tetë për kornizen afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 me banoret e fshatrave:

Zllakuqan, Berkov, Dranashiq, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Radulloc, Stupë, Rudic, Videjë, Krushevë e Madhe, Krushev e Vogel, Budisalc te komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

Të nderuar banorë të fshatrave Budisalc, Zllakuqan, Berkov, Ranoc, Leskoc, Nagllave, Radulloc, Dranshiq, Stup, Rudic, Videj, Krushev i Madh dhe Krushev i Vogël, Ju falënderoj që keni ardhur në këtë takim, sot jemi këtu për të biseduar për draft-buxhetin e vitit 2027 dhe për nevojat e fshatrave tona, qëllimi ynë është që të planifikojmë sa më mirë mjetet e buxhetit dhe t'i përdorim ato aty ku ka më shumë nevojë, ne duam të investojmë në përmirësimin e rrugëve, ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit publik dhe hapësirave të përbashkëta po ashtu, do të kemi parasysh nevojat e shkollave, bujqësisë dhe projekteve të tjera që janë të rëndësishme për banorët për ne është shumë e rëndësishme që të dëgjojmë juve. Ju i dini më së miri problemet dhe nevojat e fshatit tuaj prandaj, sot dua t'ju dëgjoj. Na tregoni cilat janë problemet më të mëdha dhe cilat projekte duhet të kenë përparësi në vitin 2027, do të mundohemi që kërkesat tuaja t'i marrim parasysh gjatë planifikimit të buxhetit ne duam që të punojmë bashkë dhe që investimet të jenë të dobishme për të gjithë banorët ju falënderoj për pjesëmarrjen, për bashkëpunimin dhe për çdo sugjerim që do ta jepni, Faleminderit!

Diskutimet e pjesëmarrësve

Vilson Zefi, Ranoc

Pershendetje te gjithve kam disa kerkesa per fshatin Ranoc: Ndërtimi i ujësjellësit Ndërtimi i trotuareve me ndriçim public, Asfaltimi i disa rrugicave të vogla.

Pergjigja e Kryetarit:

Faleminderit Vilson, Kemi paraparë projektin për fshatin Ranoc për ndërtimin e ujësjellësit, duke e marrë ujin nga pika që është në Tikshë dhe duke përdorur gypat ekzistues. Aty ku nuk ka gypa, do t'i vendosim të rinj rreth transitit, po ashtu, do të vazhdojmë me ndërtimin e pjesës së mbetur të trotuarit. Besojmë se punimet do të fillojnë në muajin nëntor, së bashku me ndriçimin public, Për ndriçimin publik do të vendosim drita solare, të cilat kanë kosto më të ulët, nuk kërkojnë mirëmbajtje të madhe dhe nuk kanë shpenzime të energjisë elektrike. Kjo do ta lehtësojë edhe komunën nga një barrë e madhe e shpenzimeve për ndriçimin publik.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 16:40

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	13
Totali	13

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu

